



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS**

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

**DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË
INTERESUARA.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nenit 6, dhe të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 18, si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimin publik, Bashkia Kamëz organizon dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit.

Titulli i projekt-aktit që hapet për konsultim me publikun:

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KAMËZ PËR VITIN 2027”**

Dëgjesat Publike drejtohen nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli.

Ftojme të gjitha grupet e interesit, si: banorë të Bashkisë Kamëz , administratorët e njësive dhe lagjeve administrative të Bashkisë Kamëz, ndërlidhës të lagjeve administrative, biznese, grupet e marginalizuara, të rinj/ të reja, shoqërinë civile, etj., të bëhen pjesë e këtyre dëgjesave për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Dëgjesat publike do të zhvillohen sipas kalendarit të mëposhtëm:

- **Për Njësinë Administrative Paskuqan**, dëgjesa do të mbahet ditën e mërkurë, më datë **09.09.2026**, në orën **19:00**, në Amfiteatrin e Liqenit të Paskuqanit.
- **Për Lagjen Administrative Bathore**, dëgjesa do të mbahet ditën e enjte, me datë **10.09.2026**,

në orën **19:00**, në Pedonalen Bathore.

- **Për Lagjet Administrative 1 dhe 2**, dëgjesa do të mbahet ditën e premte, datë **11.09.2026**, në orën **19:00**, në Pedonalen Frutikulturë.

Këto dëgjesa kanë si qëllim kryesor bashkëpunimin me komunitetin dhe mbledhjen e rekomandimeve, propozimeve dhe sugjerimeve, të cilat do të shërbejnë në procesin e planifikimit të buxhetit për vitet 2027–2029.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Këto dëgjesa do të zhvillohen në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme

